



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Publikimi Teknik - TP 30

# Katalogu i pyetjeve të testit teorik për licencë dhe autorizime të pilotit për mjete ajrore mikro të lehta

Material udhëzues

## Parathënje

Ky material udhëzues është i karakterit edukativ dhe ka për qëllim përgatitjen e kandidatëve të cilët i nënshtrohen pjesës teorike të provimit për marrjen e licencës dhe autorizimeve të pilotit për mjete ajrore mikro të lehta (MLA).

Autoriteti i Avacionit Civil i Republikës së Kosovës (AACK) me datë 30 tetor 2009, ka publikuar Rregulloren nr. 3/209 për rregullat e përbashkëta në fushën e avacionit civil. Sipas shtojcës II të kësaj Rregulloreje përshkrimi i mjeteve ajrore mikro të lehta (MLA) është i përcaktuar me sa vijon:

1. aeroplanë, helikopterë dhe parashutë me motor të cilat nuk kanë më shumë se dy ulëse, dhe me një masë maksimale të ngritjes (MTOM) jo më shumë se:
  - (a) 300 kg për aeroplan apo helikopter, me një ulëse; ose
  - (b) 450 kg për aeroplan apo helikopter, me dy ulëse; ose
  - (c) 330 kg për një amfibë ose aeroplan apo helikopter pluskues, me një ulëse; ose
  - (d) 495 kg për një amfibë ose aeroplan apo helikopter pluskues, me dy ulëse;
  - (e) 472,5 kg për një aeroplan me dy ulëse i pajisur me sistem të montuar me parashutë për shpëtim në kornizë;
  - (f) 315 kg për një aeroplan me një ulëse i pajisur me sistem të montuar me parashutë për shpëtim në kornizë, dhe aeroplanët që ka shpejtësi të stolingut (anglisht: stalling) ose shpejtësi gjatë aterrimit që nuk tejkalon 35 nyje të shpejtësisë së kalibruar (CAS);
2. gjiroplan me një apo dy ulëse me një masë maksimale të ngritjes jo më të madhe se 560 kg;
3. velore (anglisht: glider) me një masë maksimale boshe, jo më shumë se 80 kg me një ulëse ose 100 kg me dy ulëse, duke përfshirë ato të cilat të cilat nisen në këmbë;
4. mjete ajrore pa pilot me një masë operuese jo më shumë se 150 kg;
5. çdo mjet ajror tjetër që ka një masë maksimale boshe, përfshirë karburantin, jo më shumë se 70 kg.

Për të marrë licencën e pilotit apo të autorizimit përkatës të mjeteve ajrore mikro të lehta, kandidati duhet t'i nënshtrohet pjesës teorike dhe praktike të provimit, të organizuar dhe zhvilluar nga AAC-ja.

Për t'iu nënshtuar pjesës teorike të provimit, kandidati duhet të ketë rekomandimin me shkrim të organizatës së aprovuar për trajnim të pilotëve të mjeteve ajrore mikro të lehta, në të cilën është zhvilluar trajnimi, pas përfundimit të suksesshëm të të gjitha elementeve të nevojshme të trajnimit teorik. Rekomandimi i lëshuar nga organizata e aprovuar për trajnim të pilotëve për mjeteve ajrore mikro të lehta dhe është i vlefshëm **12** muaj. Nëse gjatë kësaj periudhe kandidati nuk i nënshtrohet provimit teorik, ai/ajo duhet të ofrojë

dëshmi për trajnimin shtesë të kryer nga organizata e aprovuar për trajnim të pilotëve të mjeteve ajrore mikro të lehta.

Kandidati e kalon me sukses pjesën teorike të provimit nëse ka arritur së paku 75% të numrit të poenëve të përcaktuar për secilën lëndë. Poenët ipen vetëm për përgjigjet e sakta.

Kandidati duhet të përsërisë tërë provimin teorik nëse pas tentimit të katërt nuk e ka kaluar ndonjëren lëndë, apo nëse ka skaduar periudha prej 18 muajve kalendarik prej aplikimit për herë të parë për provim. Para ri-aplikimit për pjesën teorike të provimit kandidati duhet që, në përputhje me rekomandimet e AAC-së, të kryejë trajnime shtesë në organizatën e aprovuar për trajnim të pilotëve për mjete ajrore mikro të lehta.

Suksesi i pjesës teorike të provimit është i vlefshëm për periudhën prej 24 muajve nga data e kryerjes me sukses të provimit teorik nga kandidati. Nëse gjatë kësaj periudhe kandidati nuk i nënshtronhet provimit praktik (fluturimit), atëherë kandidati duhet ta përsërisë provimin teorik në tërsi.

Në përputhje me privilegjet të cilat i merr bartësi i licencës së pilotit mjeteve ajrore mikro të lehta, kandidati duhet të demonstrojë nivelin e njohurive teorike nga lëndët vijuese:

- Procedurat e rregullta, normat dhe kufizimet mbi ekspluatimin e delta planëve
- Konstruksioni dhe materialet
- Teoria e fluturimit për mjete ajrore mikro të lehta
- Meteorologjia
- Rregullat e trafikut ajror për mjete ajrore mikro të lehta
- Situatat e rrezikshme dhe procedurat e jashtëzakonshme të mjeteve ajrore mikro të lehta
- Mjekësia e aviacionit dhe ndihma e parë
- Lista e përgjigjeve të sakta

Ky doracak është përgatitur nga AAC si material udhëzues për rregullimin e kësaj fushe të aviacionit.

Për shprehjet e ideve në këtë udhëzues mund të pretendohen të drejtë autoriale në rast se ekziston dyshimi për një shkelje të tyre. Përgatitja e një publikimi tjetër të kësaj natyre mund të ndalohet përvèç nëse dallon substancialisht nga ky udhëzues, dhe nëse nuk është kopje e tij.

Nëse keni nevojë për informata shtesë, ju lutem të na shkruani në adresën e mëposhtme:

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës  
Lagjja Arbëria  
Rruga Ahmet Krasniqi nr. 208  
10000 Prishtinë  
Republika e Kosovës

e-mail: infocaa@caa-ks.org

gat@caa-ks.org

Tel: +383 (0)38 248 629

Fax: +383 (0)38 211 009




Eset Berisha

Drejtor i Përgjithshëm

**Lista e faqeve efektive**

<b>Titulli</b>	<b>Faqe</b>	<b>Nr. Ver.</b>	<b>Data efektive</b>
Parathënie	2 nga 70	1	23 korrik 2019
Lista e faqeve efektive	5 nga 70	1	23 korrik 2019
Tabela e aprovimit	5 nga 70	1	23 korrik 2019
Lista e distribuimit	6 nga 70	1	23 korrik 2019
Tabela e revidimit	6 nga 70	1	23 korrik 2019
Tabela e përbajtjes	7 nga 70	1	23 korrik 2019
Procedurat e rregullta, normat dhe kufizimet mbi ekspluatimin e delta planëve	8nga 70	1	23 korrik 2019
Konstruksioni dhe materialet	14 nga 70	1	23 korrik 2019
Teoria e fluturimit për mjete ajrore mikro të lehta	18 nga 70	1	23 korrik 2019
Meteorologjia	38 nga 70	1	23 korrik 2019
Rregullat e trafikut ajror për mjete ajrore mikro të lehta	44 nga 70	1	23 korrik 2019
Situatat e rrezikshme dhe procedurat e jashtëzakonshme të mjetave ajrore mikro të lehta	54 nga 70	1	23 korrik 2019
Mjekësia e aviacionit dhe ndihma e parë	59 nga 70	1	23 korrik 2019
Lista e përgjigjeve të sakta	64 nga 70	1	23 korrik 2019

**Tabela e aprovimit**

	<b>Emri dhe pozita</b>	<b>Data</b>	<b>Nënshkrimi</b>
Përgatitur nga:	<b>Skender Ahmeti</b> Zyrtar i operimeve me helikopter	25 maj 2019	
Autorizuar nga:	<b>Kushtrim Musa</b> Drejtor i DSF-së	03 qershor 2019	
Kontrolli i cilësisë:	<b>Lendita Kika-Berisha</b> Drejtor i DCS-së	22 korrik 2019	
Aprovuar nga:	<b>Eset Berisha</b> Drejtor i përgjithshëm	23 korrik 2019	

**Lista e distribuimit**

Kopje nr.	Vendndodhja	Media	Sasia
1	Libraria e AAC-së	Origjinali	1
2	Serveri i dosjeve të AAC-së	Digitale	1

**Tabela e revidimit**

Nr. Rev.	Datë	Përgatitur nga:	Autorizuar nga:

## Tabela e përbajtjes

Parathënje	2
Lista e faqeve efektive	5
Tabela e aprovimit	5
Lista e distribuimit	6
Tabela e revidimit	6
Tabela e përbajtjes	7
Procedurat e rregullta, normat dhe kufizimet mbi eksploatimin e delta planëve	8
Konstruksioni dhe materialet	14
Teoria e fluturimit për mjete ajrore mikro të lehta	18
Meteorologjia	38
Rregullat e trafikut ajror për mjete ajrore mikro të lehta	44
Situatat e rrezikshme dhe procedurat e jashtëzakonshme të mjetave ajrore mikro të lehta	54
Mjekësia e avacionit dhe ndihma e parë	59
Lista e përgjigjeve të sakta	64

**Procedurat e rregullta, normat dhe kufizimet  
mbi përdorimin e mjeteve ajrore mikro të lehta**

**1) Sasia e vajit për lubrififikim kontrollohet:**

- (a) kur motori është në funksion dhe punon në rrotullime të ulëta,
- (b) menjëherë pasi motori është fikur para se vaji të kthehet në koriten e vajit.
- (c) në tokë, kur motori nuk është në funksion (i fikur),

**2) Vaji qarkullon nëpër motor, me ndihmën e:**

- (a) pompës elektrike,
- (b) pompës të shtyrë nga motori,
- (c) parimit të rënies së lirë,
- (d) inercionit të dhëmbëzorit të motorit.

**3) Cilët nga instrumentet standarde të cekura, me të cilat janë të pajisura mjetet e lehta ajrore, vazhdojnë të punojnë në rast të dështimit të burimit të energjisë elektrike?**

- (a) horizonti artificial, treguesi i shpejtësisë vertikale, busulla zhiroskopike, matësi i shpejtësisë,
- (b) matësi i lartësi, treguesi i shpejtësisë vertikale dhe matësi i shpejtësi,
- (c) matësi i lartësi, treguesi i shpejtësisë vertikale, treguesi i kthimit dhe rrëshqitjes dhe matësi i shpejtësisë,
- (d) matësi i lartësi dhe shpejtësisë.

**4) Forca kryesore që mundëson realizimin e funksioneve themelore të parashutës është:**

- (a) forca e gravitetit të tokës,
- (b) forca e ngritjes,
- (c) rezistenca e ajrit,
- (d) forca rezultante.

**5) Çfarë paraqet harku i gjelbër në instrumentet e mjetit ajror?**

- (a) zona e shpejtësisë, kur është i mundshëm përdorimi i rrotave për ulje dhe flapsave (anglisht: flaps)
- (b) vlera maksimale e lejuar,
- (c) zonë e rrezikshme.
- (d) zona e përdorimit normal,

6) Çfarë paraqet harku i verdhë në instrumentet e mjetit ajror?

- (a) vlera maksimale e lejuar,
- (b) zonën e kufirit të e kujdesit të shtuar,
- (c) zonë e shpejtësisë kur mund të përdorim pajisjet për uljeje (rrotat) dhe flapsat,
- (d) zona e përdorimit normal.

7) Gomat e mjetit ajror me profil të ngushtë dhe presion më të lartë, janë më të përshtatshme për ulje:

- (a) në pistë me bari
- (b) në fusha ajrore të forta dhe me gunga,
- (c) në beton dhe pistë asfalti,
- (d) në pista të buta me bar dhe të lagura.

8) Burimi kryesor i energjisë elektrike, kur motori punon është:

- (a) magneti,
- (b) dinamo ose alternatori,
- (c) bateria,

9) Çka shërben vija e kuqe në rrotën dhe gomën e parë të hundës të mjetit ajror:

- (a) kontrollin e gomës se nuk ka lëvizur nga rrota e hundës,
- (b) centrimi i rrotës,
- (c) identifikimi i llojit të gomave,
- (d) kontrollin e presionit të ajrit në gomë.

10) Cila është metoda më e sigurt praktike e kontrollit të sasisë së karburantit në rezervuar, kur mjeti ajror është në tokë:

- (a) inspektimi vizual i sasisë së karburantit në mjetin ajror,
- (b) luhatjen e krahëve duke dëgjuar shushurimën e karburantit në rezervuar,
- (c) leximi i matësit të karburantit,
- (d) matja e peshës së mjetit ajror.

11) Cila papastërti e dëmshme është më së vështiri të largohet nga karburanti në mënyrën e thjesht të filtrimit?

- (a) uji,
- (b) grimca të vogla të ndryshkut dhe papastërtitë tjera,

- (c) akulli,
- (d) yndyra ose vaji.

**12) Roli i karburatorit (anglisht: carburetor) tek motori me pistona është:**

- (a) sjellja e ajrit në pistona të motorit
- (b) sjellja e përzierjes së karburanteve dhe ajrit në cilindrat e motorit,
- (c) shkarkimi i gazrave të djegies nga gypi për lirimin e gasrave (anglisht: exhaust pipe),
- (d) sjellja e karburantit në cilindra të motorit.

**13) Fuqia e motorit zvogëlohet me lartësi për shkak të:**

- (a) dendësisë së ajrit më të vogël, mbushja e cilindrave nuk është e mjaftueshme,
- (b) temperaturës së ulët, sepse motori nuk punon në temperaturë optimale operative
- (c) dendësia e lartë e ajrit, motori merr një përzierje të varför
- (d) dendësia e ulët e ajrit, motori merr përzierje shumë të pasur.

**14) Mjeti ajror me piston zhvillon fuqi maksimale:**

- (a) në lartësi të larta,
- (b) gjatë ngritjes, pa marrë parasysh rrrotullimet,
- (c) gjatë ngritjes me rrrotullime të plota (maksimale),
- (d) në regjimin e fluturimit horizontal në lartësi të ulët.

**15) Blloku i motorit modern i mjetit ajror është bërë nga:**

- (a) legura e çelikut,
- (b) bronzi,
- (c) legura e aluminit,
- (d) legura e titanit.

**16) Vaji në motorët me piston shërben për:**

- (a) lubrififikimin dhe ftohjen e motorit,
- (b) rritjen e temperaturës së djegies të përzierjes në cilindra,
- (c) ekskluzivisht për punën e qetë të motorit,
- (d) si shtesë për përzierje e cila digjet në cilindra.

**17) Ku mund të gjejmë informacionin e llojit të vajit që është i paraparë për motorin e mjetit ajror tonë:**

- (a) të gjitha mjetet ajrore me piston përdorin vaj të njëjtë me shenjen SAE40 (80Nj),
- (b) në etiketë të enës për vaj,
- (c) në manualin e fluturimit të mjetit ajror,
- (d) në pllakën pranë shufrës për matjen e vajit.

**18) Cila është procedura normale, nëse pas startimit të motorit të ngrohtë presioni i vajit nuk shfaqet brenda kohës së caktuar:**

- (a) të ndalet motori,
- (b) të rriten rrötullimet e motorit në mënyrë që pompa e vajit të motorit të rris presionin e vajit
- (c) të mos ndërmerret asgjë, sepse instrumentet në mjetet ajror moderne janë të lirë dhe jo të besueshme,
- (d) të varfërohet përzierja, ashtu që menjëherë të ngritet temperatura në kokën e cilindrave.

**19) Motori i mjetit ajror me piston mund të kyçët në punë (startoj), në qoftë se ju e sillni helikën me dorë:**

- (a) po, nëse magnetet janë të kyçur,
- (b) normalisht jo, nëse është ftohtë dhe nëse ndezja është e çkyçur,
- (c) jo, në asnjë rrethanë,
- (d) po, gjithmonë.

**20) Kabllot më të forta në konstruksionin e mjetit ajror me motor janë:**

- (a) të poshtmet dhe të lartat anësore,
- (b) tensioneri (shtrënguesi),
- (c) të poshtmet anësore,

**21) Helika me reduktor ka shpejtësinë e rrötullimit:**

- (a) më të madhe se shpejtësia e rrötullimit të motorit,
- (b) më të vogël se shpejtësia e rrötullimit të motorit,
- (c) e njëjtë si shpejtësia e motorit kur bëhet fjalë për helika me shpejtësi konstante,
- (d) helika me tre ose më shumë krah ka shpejtësi më të madhe,

**22) Nëse lartësimatësi në tokë, është vendosur të lexoj 0m, ndërsa të nesërmen ky instrument lexon 20m, kjo do të thotë që presioni:**

- (a) është rritur,
- (b) mbetet i njëjtë,
- (c) ka rënë,

**23) Çka e përcakton zgjedhjen e parashutës për mjete ajrore mikro të lehta:**

- (a) pesha dhe shpejtësia e mjetit ajrore mikro të lehtë,
- (b) shpejtësia maksimale e mjetit ajrore mikro të lehtë
- (c) karakteristikat konstruktive të mjetit ajror mikro të lehtë.

## Konstruksioni dhe materialet

**24) Skeleti i krahut përbëhet nga:**

- (a) pëlhura e shpinës së skeletit,
- (b) gypat nga legura e aluminit, pllakat dhe vidat që i bashkojnë si dhe kabllot,
- (c) trekëndëshi, shpina dhe gypat metalik.

**25) Njësia motorike përbëhet nga:**

- (a) motori, reduktori dhe helika,
- (b) motori, komandat e motorit dhe helika,
- (c) helika, reduktori, komandat e motorit dhe mbajtësi i motorit.
- (d) motori dhe helika,

**26) Ndikimi më i dëmshëm mbi sipërfaqen e krahut është nga:**

- (a) lagështia,
- (b) temperatura,
- (c) dielli,
- (d) presioni.

**27) Dizajni i mjetit ajror motorik mund të përballojë ngarkesë në fluturim:**

- (a) + 4 / - 2 g
- (b) + 6 / - 3 g
- (c) + 4 / - 4 g
- (d) + 5 / - 2 g.

**28) Buloni vetë-sigurues mund të hiqet dhe vendoset në vendin e vetë:**

- (a) 2 herë,
- (b) 3 herë,
- (c) vetëm 1 herë,
- (d) 5 herë.

**29) Burimi kryesor i energjisë elektrike në fluturim është:**

- (a) alternatori – magneti,

- (b) rryma e ajrit,
- (c) bateria,

30) Sa fije teli të dëmtuara mund ti ketë një kabllo (sajllë):

- (a) një,
- (b) asnjë,
- (c) deri në  $\frac{1}{4}$ ,
- (d) dy.

31) Kontrolli i frenave në mjete ajrore të lehta bëhet gjatë:

- (a) rritjes së shpejtësisë në tokë,
- (b) fluturimit,
- (c) vozitjes,
- (d) ndaljes.

32) Gomat qëndrojnë më gjatë në qoftë se ngritja bëhet nga:

- (a) asfalti,
- (b) betoni,
- (c) bari,
- (d) sipërfaqja e tokës.

33) Puna e motorit me bateri, kapaciteti i së cilës është zvogëluar është:

- (a) e sigurt,
- (b) e pamundur,
- (c) është e mundur, por shkurtër,
- (d) nuk është e sigurt.

34) Mjetet ajrore mikro të lehta është e preferuar të përdorin bateri me:

- (a) xhel,
- (b) thartirë,
- (c) shkumë.

35) Pjesët kryesore të parashutës janë:

- (a) kupola me litarë, skajet e lira, karabina,
- (b) kupola me litarë, sistemi i lidhjeve, pajisja për aktivizim,

- (c) kupola me litarë, lidhëset e karabinës, parashuta e vogël që e aktivizon kopolën e parashutës kryesore,
- (d) parashuta stabilizuese, kupola me litarë, pajisje për ngadalësim të procesit të hapjes të sistemit të lidhjeve.

**36) Qëllimi kryesor i parashutës është:**

- (a) që të ngadalësoj shpejtësinë e uljes,
- (b) që të stabilizoj uljen e njerëzve dhe materiale në tokë.
- (c) që në mënyrë të sigurte të bëj uljen e njerëzve dhe materialeve në tokë,

**37) Parashuta fillestare (pilot parashuta) shërben për:**

- (a) stabilizimin e parashutës,
- (b) të filluar procesin e hapjes së kopolës kryesore,
- (c) ngadalësimin e procesin e hapjes,
- (d) kontrollin e procesit të hapjes së kopolës kryesore.

**38) Për cilën pjesë të mjetit ajror mikro të lehtë është e lidhur parashuta për shpëtim:**

- (a) mbajtësit të trupit,
- (b) krahu,
- (c) pilotit,
- (d) mbajtësit të motorit.

**39) Pjesa qendrore e kopolës kryesore përmban "valvulen". Qëllimi i kësaj vrimë është:**

- (a) që të parandaloj ngarkesën e kopolës në procesin e hapjes,
- (b) që të reduktoj goditjet dinamike gjatë hapjes së parashutës,
- (c) që të mundësoj lirimin e ajrit nga kupola për ta mundësuar hapjen stabile të kopolës,
- (d) që të mundësoj manipulimin me kupolë.

**Teoria e fluturimit për mjete ajrore mikro të lehta**

40) Cilat janë katër forca që ndikojnë në mjet ajror gjatë fluturimit:

- (a) forca shtytëse, ngritja, pesha dhe rezistenca,
- (b) forca, shpejtësia, pesha dhe fërkimi,
- (c) forca, shpejtësia, pesha dhe rezistenca,
- (d) forca shtytëse, ngritja, nxitimi gravitues dhe pesha;

41) Rezistenca që rezulton nga barazimi i presionit në skajet e krahëve quhet:

- (a) rezistenca induktive,
- (b) rezistenca interferuese,
- (c) rezistenca konstante,
- (d) rezistenca totale;

42) Si ndryshon rezistenca induktive me shpejtësinë e mjetit ajror:

- (a) nuk varet nga shpejtësia,
- (b) rritet me zvogëlimin e shpejtësisë,
- (c) rritet me rritjen e shpejtësisë, vetëm në shpejtësi më të mëdha se 180 kt,
- (d) zvogëlohet me uljen e shpejtësisë;

43) Cila formë e krahëve ka rezistencë më të madhe induktive:

- (a) trapezoide e dyfishtë,
- (b) trapezoide,
- (c) drejtkëndëshe,
- (d) eliptike;

44) Në cilin drejtim rrotullohen rotorët në skajet e krahut:

- (a) në anën e kundërt të lëvizjes së akrepit të orës në krahun e djathtë duke shikuar nga kabina në drejtim të fluturimit,
- (b) në anën e lëvizjes së akrepit në orë në krahun e majtë dhe në të kundërtën e lëvizjes së akrepit të orës në krahun e djathtë duke shikuar nga kabina në drejtim të fluturimit,
- (c) ashtu që aksi i rrotullimit të rrymës të jetë paralel me mbajtësit e krahëve;

45) Shpejtësia e paqëndrueshmërisë në ajër (anglisht: stalling) në ngritje sipas shpejtësimatësit, kur mjeti ajror fluturon përball erës, në raport me situatën kur fluturon në drejtim të erës, është:

- (a) rritur për vlerën e komponentës së zgjatur të erës,
- (b) e pandryshuar, pasi era nuk ndikon në shpejtësinë e paqëndrueshmërisë në ajër (stall),
- (c) zvogëluar me vlerën e komponentit gjatësor të erës,
- (d) zvogëluar për gjysmën e vlerës së komponentit gjatësor të erës;

**46) Katër forca që ndikojnë në mjetin ajror janë në ekuilibër kur mjeti ajror:**

- (a) gjendet në tokë,
- (b) nxiton në fluturim,
- (c) zvogëlon shpejtësinë gjatë fluturimit;
- (d) fluturon me shpejtësinë progresive e cila është konstante,

**47) Shpejtësia e manovrimit të një mjetit ajror (Va) është shpejtësia në të cilën piloti nuk mund të kalojë me timonit të lartësisë në devijim të papritur në:**

- (a) shpejtësinë e cila kur nuk mund të tejkalohet (Vne),
- (b) mbingarkesën  $+1g$ ,
- (c) vlerat pozitive të mbingarkesës së lejuar  $+ g$ ,
- (d) vlerat negative të mbingarkesës së lejuar  $- g$ ;

**48) Në fazën e aterrimit në kushte të erës me intensitet të ndryshëm (anglisht: Gust Wind), ne fluturojmë me shpejtësi normale të afrimit për aterrim?**

- (a) jo, shpejtësinë e afrimit duhet rritur për gjysmën e vlerës së shpejtësisë së erës me intensitet të ndryshëm, (Gust Wind),
- (b) po, (shih udhëzimin e pilotit për eksplorimin e aeroplanit),
- (c) jo, nevojitet shpejtësia prej 1,2 Vs.

**49) Gjatë aterrimit në aeroport me lartësi të madhe mbidetare, shpejtësia reale ajrore (TAS) e mjetit ajror është më e madhe nga normalja. Çfarë shpejtësie instrumentale (IAS) mbajmë në këto raste:**

- (a) normale,
- (b) më të vogël se normale,
- (c) më të madhe se normale,
- (d) rritet për 5 kt për çdo 1.000 ft të lartësisë mbidetare;

**50) Me çfarë shpejtësie fluturojmë me mjet ajror, respektivisht me delta plan me motor deri në pengesa tek ngritja nga terrenet e shkurtra me pengesa:**

- (a) me shpejtësi manovruese (Va),

- (b) me shpejtësi minimale ( $V_s$ ),
- (c) me shpejtësinë e këndit më të lartë të ngritjes ( $V_x$ ),
- (d) me shpejtësi të ngritjes më të mire ( $V_y$ );

**51) Si ndikon era në shpejtësinë vertikale të ngritjes:**

- (a) era nga pas (anglisht: tail wind) rritë shpejtësinë vertikale të ngritjes,
- (b) era nga pas zvogëlon shpejtësinë vertikale të ngritjes,
- (c) era ballore (anglisht: head wind) e rrit shpejtësinë vertikale të ngritjes;
- (d) era nuk ka kurrfarë ndikimi në shpejtësinë vertikale të ngritjes,

**52) Si ndikon era në këndin më të lartë të ngritjes:**

- (a) era nga pas e rritë këndin e ngritjes,
- (b) era ballore e rritë këndin më të lartë të ngritjes,
- (c) era nuk ka kurrfarë ndikimi në këndin më të lartë të ngritjes,
- (d) era e ballore zvogëlon këndin më të lartë të ngritjes;

**53) Në çfarë raporti të ndërsjellët janë ngritja, rezistanca, forca shtytëse dhe peshë, në fluturimin horizontal dhe drejtim të caktuar të mjetit ajror me shpejtësi konstante?**

- (a) forca ngritëse është e barabartë me peshën, ndërsa forca shtytëse e barabartë me rezistencën e mjetit ajror,
- (b) forca ngritëse është e barabartë me rezistencën, ndërsa forca shtytëse me peshën e mjetit ajror,
- (c) shuma e forcës ngritëse dhe peshës është shuma (përbledhja) e forcës shtytëse dhe rezistencës së mjetit ajror,
- (d) shuma (përbledhja) e forcës ngritëse, rezistencës dhe peshës, është e barabartë me forcën shtytëse të mjetit ajror;

**54) Kur fluturojmë me mjet ajror i cili ka motor me piston dhe me shpejtësinë e qëndrimit më të gjatë në ajër atëherë:**

- (a) Kalojmë distancën më të madhe me sasinë e dhënë të karburantit (fluturojmë me forcën më të vogël të rezistencës),
- (b) kalojmë distancën më të madhe ndërmjet dy mbushjeve me karburant;
- (c) motori konsumon më së paku karburant për njësi të kohës (fluturojmë me fuqinë më të vogël),

**55) Forca ngritëse në krahun e mjetit ajror:**

- (a) është rezultat i ndryshimit të presionit në pjesën e epërme dhe presionit në pjesën e poshtme të krahut,
- (b) vepron vertikalish,
- (c) ka gjithmonë vlerë të njëjtë si forca e gravitacionit, përndryshe mjeti ajror nuk do të mund të fluturonte,
- (d) ka qendër të forcës në qendrën e gravitetit të mjetit ajror;
- 56) Gjatë hapjes së flatrave (anglisht: flaps), vjen deri te rritja e forcës ngritëse për shkak të:
- (a) zvogëlimit të rezistencës induktive,
- (b) rritjes së ndikimit të këndit sulmues dhe profilit të krahut në formë harku (anglisht: cambered),
- (c) zvogëlimit të krijimit të rezistencës,
- (d) zvogëlimit të këndit sulmues;
- 57) Gjatë uljes me flatra të hapura (flaps) shpejtësia e thyerjes së forcës ngritëse në raport me fluturimin pa flatra (flaps) është:
- (a) më e vogël,
- (b) e pandryshuar, sepse nuk varet nga pozita e flatrave (flaps),
- (c) më e madhe;
- 58) Cila është pozita jo e sigurt e qendrës së gravitetit në kuptim të stabilitetit gjatësor:
- (a) Balanci prapa,
- (b) Balanci anësor tej mase,
- (c) balanci i përparëm,
- (d) pozita shumë e ulët e qendrës së gravitetit të mjetit ajror.
- 59) Boshti gjatësor i mjetit ajror është boshti i cili shtrihet nga:
- (a) nga njëra anë deri tek ana tjetër e krahut dhe përmes qendrës së gravitetit të mjetit ajror,
- (b) hunda e mjetit ajror deri tek bishti i mjetit ajror përmes qendrës së e gravitetit të mjetit ajror,
- (c) nga njëra anë në anën tjetër të krahut dhe përmes qendrës së gravitetit të mjetit ajror;
- 60) Si e definojmë stabilitetin e mjetit ajror rreth boshtin gjatësor:

- (a) stabiliteti anësor,
- (b) stabiliteti i drejtimit,
- (c) stabiliteti gjatësor;
- (d) stabiliteti i tërthortë,

**61) Stabiliteti i mjetit ajror rreth boshtit gjatësor (stabiliteti i tërthortë) sigurohet:**

- (a) me pjerrtësinë (anglisht: dihedral) e krahëve, respektivisht pozitës së ulët të qendrës së gravitetit të mjetit ajror,
- (b) me balansin aerodinamik të krahut,
- (c) me shigjetën e krahëve,
- (d) me lakueshmërinë aerodinamik të krahëve;

**62) Cilët pjesë të mjetit ajror janë të dedikuara për krijimin e stabilitetit rreth boshtit vertikal:**

- (a) pjerrtësia (dihedral) e krahëve,
- (b) të gjitha sipërfaqet vertikale të bishtit,
- (c) vetëm stabilizatori vertikal,
- (d) vetëm timoni i drejtimit të hundë djathtas-majtas (anglisht: rudder).

**63) Tek helikat me hap ndryshues, hapi i vogël shfrytëzohet:**

- (a) në ngritje, aterrim dhe ngjitje në lartësi,
- (b) në fluturim horizontal (anglisht: cruising),
- (c) në ngritje dhe ngjitje në lartësi;

**64) Lundrimi (anglisht: gliding) i mjetit ajror varet nga:**

- (a) Masa e përgjithshme,
- (b) raporti ndërmjet forcës ngritëse dhe rezistencës,
- (c) raportit ndërmjet rezistencës dhe forcës shtytëse.

**65) Cilët kushte normalisht rrisin forcën ngritëse:**

- (a) zvogëlimi i këndit sulmues konstruktiv të krahut dhe rritja e shpejtësisë,
- (b) zvogëlimi i këndit sulmues të krahut dhe rritja e dallimit të këndeve sulmuese të krahëve dhe të stabilizatorit horizontal,
- (c) rritja e këndit sulmues të krahut dhe rritja e shpejtësisë,
- (d) rritja e këndit sulmues ndërmjet boshtit gjatësor të mjetit ajror dhe horizontit dhe zvogëlimit të shpejtësisë;

**66) Shpejtësia maksimale e ngritjes vertikale do të jetë:**

- (a) në kufirin e epërm të fluturimit,
- (b) në momentin e ndarjes nga pista,
- (c) në gjysmën e lartësisë së kufirit të epërm të fluturimit;

**67) Gjatë hapjes së flatrave (flaps), rritet lakueshmëria e profilit të krahut. Si ndikon kjo në forcën e ngritjes dhe rezistencën e mjetit ajror:**

- (a) të dyja rriten,
- (b) të dyja zvogëlohen,
- (c) forca ngritëse zvogëlohet, rritet rezistenca,
- (d) forca ngritëse rritet, rezistenca zvogëlohet.

**68) Gjatë fluturimit në mjetin ajror me dy ose më shumë ulëse, kur janë dy persona në mjet ajror duhet të kushtohet kujdes sepse:**

- (a) këndi kritik sulmues është më i madh,
- (b) tek dështimi i motorit lundrimi (gliding) është më i madh,
- (c) shpejtësia e thyerjes së forcës ngritëse është më e vogël,
- (d) shpejtësia e thyerjes së forcës ngritëse është më i madh.

**69) Mjeti ajror në kthesë stabile (anglisht: stationary) fluturon me:**

- (a) këndin sulmues të krahëve më të madh se ai në fluturimin horizontal,
- (b) rrëshqitjen në krahë,
- (c) këndin sulmues të njëjtë si në fluturimin horizontal,
- (d) këndin sulmues të krahëve më të vogël se ai në fluturimin horizontal.

**70) Në rreth, forca ngritëse duhet të jetë:**

- (a) gjithmonë dy here më e madhe se ajo në fluturimin horizontal,
- (b) më e madhe se ajo në fluturimin horizontal,
- (c) më e vogël se sa në fluturimin horizontal, sepse forca centrifugale plotëson një pjesë të forcës ngritëse,
- (d) e barabartë me atë në fluturimin horizontal.

**71) Cila është pasoja e shkëputjes së rrymave nga pjesa e epërme e krahëve në gjatë rrotullimit në rreth?**

- (a) humbja e forcës ngritëse,
- (b) rrëshqitje e jashtme anësore,
- (c) rrëshqitje e brendshme anësore,

- (d) fuqia e madhe e nevojshme për lëvizjen e timonit të hundës (rudder).
- 72) Pjerrtësia më e madhe e lejuar në rreth, me mbingarkesë prej  $+ 2,5 \text{ g}$  është: (shih foton)
- (a)  $66^\circ$   
(b)  $52^\circ$   
(c)  $60^\circ$   
(d)  $74^\circ$
- 73) Mbingarkesa e mjetit ajror në rreth me pjerrtësi  $60^\circ$  është: (shih foton)
- (a)  $2,0 \text{ g}$ ,  
(b)  $0,5 \text{ g}$ ,  
(c)  $1,0 \text{ g}$ ,  
(d)  $1,5 \text{ g}$ .
- 74) Shpejtësia instrumentale e thyerjes (shpejtësia minimale instrumentale) së forcës ngritëse me rritjen e lartësisë:
- (a) zvogëlohet njëtrajtëshëm,  
(b) rritet njëtrajtshëm,  
(c) mbetet e pandryshuar.
- 75) Mjeti ajror i cili pas tre oscilimeve kthehet në pozitën e fluturimit të qëndrueshëm, pasi që piloti për një kohë të shkurtër ka tërhequr dorezën e komandimit (anglisht: stick) në drejtim të tij, është:
- (a) stabil në aspektin dinamike,  
(b) labil – jo stabil në aspektin dinamike,  
(c) indiferent në aspektin dinamike,  
(d) stabil në aspektin statike.
- 76) Pse piloti duhet të ketë parasysh që pozita e qendrës së gravitetit të mjetit ajror të mbetet brenda kufijve të përcaktuar:
- (a) me këtë arrihet vlera e ulët të shpejtësisë minimale,  
(b) ashtu parandalon që mos të vjen deri tek mbingarkesa e mjetit ajror,  
(c) me këtë arrihet stabiliteti i duhur dhe në ajër i mjetit ajror,  
(d) me këtë arrin vlerën e mjaftueshme të shpejtësisë minimale.
- 77) Sa është forca e nevojshme në dorezën e komandimit (stick) para kontaktit me

**tokë, (touchdown) nëse mjeti ajror është i ngarkuar gabimisht dhe për këtë arsy qendra e gravitetit është zhvendosur përparr pozicionit normal:**

- (a) normale,
- (b) më e vogël se normale;
- (c) më e madhe se normale.

**78) Fusha me shpejtësi nën asaj të zërit (anglisht: subsonic) e rrymimit të ajrit në raport me numrin e Mah-ut është:**

- (a)  $0.2 < M < 0.8$ ,
- (b)  $0.8 < M < 1.4$ ,
- (c)  $0 < M < 0.2$ .

**79) Fusha me shpejtësi të afërt asaj të zërit (anglisht: transonic) e rrymimit të ajrit në raport me numrin e Mah-ut është:**

- (a)  $0.8 < M < 1.4$ ,
- (b)  $0 < M < 0.2$ ,
- (c)  $0.2 < M < 0.8$ .

**80) Relacioni i saktë ndërmjet 1m dhe 1ft (anglisht: feet) është:**

- (a)  $0.305\text{m}=1.5\text{ft}$ ,
- (b)  $1\text{m}=4.28\text{ft}$ ,
- (c)  $1\text{m}=3.2\text{ft}$ .

**81) Në cilat njësi të matjes shprehet numri i Mah-ut?**

- (a) nuk ka njësi,
- (b)  $\text{m/s}$ ,
- (c)  $\text{km/h}$ .

**82) Linja e kordës (anglisht: chord line) e profilit ajror në ilustrim, është e shënuar me shkronjën: (shih foton)**

- (a) C,
- (b) B,
- (c) A.

**83) Pjesa e epërme e profilit ajror, në ilustrim, është e shënuar me shkronjën: (shih foton)**

- (a) B,
- (b) C,
- (c) A.

84) Me rritjen e këndit të sulmit (anglisht: angle of attack) të krahut, rezistenca induktive ka tendencën e:

- (a) mbetet konstante,
- (b) rritjes,
- (c) uljes.

85) Përafërsisht sa kohë pas kalimit të një mjeti të madh ajror, mbetet turbulenca në ajër:

- (a) pesë minuta ose më shumë. ATC rekomandon për mjete të lehta ajrore dy deri në tre minuta mesë ngritjeve,
- (b) dy minuta,
- (c) tre minuta.

86) Tek mjeti ajror me piston, distanca e fluturimit (anglisht: range) maksimale është në:

- (a) lartësitë e mëdha,
- (b) lartësitë e vogla,
- (c) lartësitë e mesme.

87) Kufiri praktik i shpejtësisë vertikale të ngritjes për mjete ajrore me piston gjatë fluturimit është

- (a) 0,5 m/s
- (b) 1 m/s
- (c) 0 m/s

88) Në rreth të koordinuar horizontal, koeficienti normal i ngarkesës varet nga:

- (a) këndi i pjerrësisë së krahut gjatë rrethit,
- (b) rrëzës së kthesës (anglisht: turn radius),
- (c) shpejtësisë së hyrjes në rreth.

89) Komandimi i mjetit ajror në pjerrësi (kthesë) kryhet përmes:

- (a) flatrat (anglisht: flaps),
- (b) eleronet (anglisht: ailerons),
- (c) timonit drejtues (anglisht: rudder).

**90) Këndi i sulmit (anglisht: angle of attack) është këndi ndërmjet:**

- (a) Linja e kordës (chord line) së profilit të krahut dhe rrymimit të ajrit në ardhje,
- (b) boshtit gjatësor të trupit të aeroplanit dhe Linja e kordës (chord line)të krahut,
- (c) gjatësore gjatësor të trupit tëmjetit ajror dhe rrymimit të ajrit në ardhje ,
- (d) kordës (chord) së profilit të stabilizatorit horizontal dhe kordës (chord) së profilit të krahut.

**91) Këndi ndërmjet rrymimit të ajrit në ardhje dhe linjës së kordës së profilit të krahut është:**

- (a) këndi konstruktiv,
- (b) këndi i zhytjes (dive angle),
- (c) këndi hyrës (Incidence angle),
- (d) këndi i ngritjes.

**92) Cili është këndi i sulmit të krahut, pranë të cilit presim thyerje të forcës ngritëse:**

- (a)  $3^\circ - 5^\circ$
- (b)  $5^\circ - 10^\circ$
- (c)  $10^\circ - 18^\circ$
- (d) më i madh se  $25^\circ$ .

**93) Këndi kritik i sulmit të krahut të mjetit ajror:**

- (a) ndryshon, nëse ndryshon masa e mjetit ajror,
- (b) nuk varet nga masa dhe qendra e gravitetit të mjetit ajror,
- (c) zvogëlohet, nëse qendra e gravitetit të mjetit ajror lëviz prapa,
- (d) rritet, nëse qendra e gravitetit të mjetit ajror lëviz përpara.

**94) Këndi konstruktiv është:**

- (a) këndi ndërmjet kordës (chord) së profilit të krahut dhe boshtit gjatësor të mjetit ajror,
- (b) këndi ndërmjet drejtimit të rrymimit të ajrit dhe kordës (chord) së profilit të krahut,
- (c) këndi ndërmjet timont të lartësisë dhe kordës (chord) së stabilizatorit horizontal,
- (d) distanca nga brinja ballor e krahut (wing rib) dhe boshti gjatësor të aeroplanit.

95) Çfarë ndodh me ngritjen dhe rezistencën e krahëve, në qoftë se krahu kalon këndin kritik të sulmit:

- (a) ngritja dhe rezistenca mbesin të njëjtë në këndin sulmues kritik,
- (b) ngritja fillon të bie, ndërsa rezistenca ende rritet,
- (c) ngritja edhe më tutje rritet, ndërsa rezistenca fillon të bije-ulet,
- (d) ngritja dhe rezistenca fillojnë të uljen.

96) Kur në mjetin ajror vjen deri te thyerja e forcës së ngritjes:

- (a) vetëm kur hunda e mjetit ajror është lartë mbi horizontin me shpejtësi të ulët,
- (b) vetëm kur hunda e mjetit ajror është lartë mbi horizontin,
- (c) vetëm kur shpejtësia bie nën vlerat e dhëna në udhëzues,
- (d) në çdo shpejtësi dhe nën këndin kritik sulmues.

97) Cilat dy forca krijojnë fuqinë aerodinamike rezultuese:

- (a) rezistenca dhe shpejtësia,
- (b) ngritja dhe rezistenca,
- (c) shpejtësia dhe rezistenca ballore,
- (d) ngritja dhe shpejtësia.

98) Këndi sulmues është:

- (a) këndi ndërmjet drejtimit të forcës së gravitetit tokësor dhe rrymimeve relative,
- (b) këndi ndërmjet forcës së rezistencës dhe rrymimeve relative,
- (c) këndi ndërmjet drejtimit të rrymimit relativ dhe kordës (chord) së aeroprofilit,
- (d) këndi ndërmjet rrymimit relativ dhe skajit sulmues të aeroprofilit.

99) Profili ajror është:

- (a) sipërfaqja e cila prodhon ngritje,
- (b) sipërfaqja me të cilën kompensohet forca e rezistencës,
- (c) sipërfaqja e cila fitohet me prerjen gjatësore të sipërfaqes bartëse,
- (d) prerje anësore e trupit rreth të cilit zhvillohet rrymimi ajror,

100) Me rritjen e këndit sulmues të krahut:

- (a) rritet fuqia e ngritjes dhe rezistencës,
- (b) zvogëlohet lundrimi (gliding),
- (c) rritet lundrimi (gliding),

- (d) rritet rezistenca induktive.

**101) Lundrimi (gliding) është raporti ndërmjet:**

- (a) peshës dhe distancës së fluturimit,
- (b) distancës së lundrimit dhe humbjes së lartësisë,
- (c) shpejtësisë vertikale dhe horizontale,
- (d) shpejtësisë horizontale dhe distancës së fluturimit.

**102) Profili ajror është profili të cilin e fitojmë me:**

- (a) prerjen tërthore të krahut,
- (b) prerjen gjatësore të krahut,
- (c) prerjen e pjerrët të krahut,
- (d) raportin e tërthortë të realizuar të forcës ngritëse dhe rezistencës.

**103) Linja e korda (anglisht: chord line) së profilit është:**

- (a) linja e lartë e lakuar e cila lidh pikat përfundimtare të profilit,
- (b) linja e lakuar e cila lidh pikat përfundimtare të aeroprofilit,
- (c) linja e drejtë e cila bashkon pikat përfundimtare të profilit,
- (d) linja e cila kalon përmes pikës e shtyqjes me linjën e poshtme të lakuar.

**104) Forca ngritëse është:**

- (a) forca aerodinamike me ndikimin e rrymës ajrore në krahun i cili e kundërshton forcën e gravitetit,
- (b) forca aerodinamike e krijuar me ndikimin e rrymës aerodinamike në krahun i cili e kundërshton rezistencën induktive,
- (c) forca aerodinamike e krijuar me veprimin e rrymës ajrore në krahun i cili e kundërshton rezistencës parazitare,
- (d) forca aerodinamike e cila është krijuar me ndikimin e rrymës ajrore në krahun i cili e kundërshton forcën e gravitetit.

**105) Qendra shtytëse:**

- (a) me rastin e rritjes së këndit sulmues lëviz në drejtim të skajit sulmues të krahut,
- (b) me rastin e rritjes së këndit sulmues lëviz në drejtim të skajit dalës të krahut,
- (c) është pika fiksë dhe nuk ndryshon me ndryshimin e këndit sulmues,
- (d) lëviz në drejtim të skajit sulmues gjatë rritjes së dendësisë së ajrit.

**106) Fuqia ngritëse shfaqet në sipërfaqen e epërm të aeroprofilit, me rastin e:**

- (a) zvogëlimit të presionit (pressure) si pasojë e shpejtësisë më të madhe të fluidit,
- (b) rritjes së presionit (pressure) si pasoj e shpejtësisë më të madhe të fluidit,
- (c) rritjes së presionit (pressure) si pasoj e shpejtësisë më të ulët të fluidit,
- (d) zvogëlimit të presionit (pressure) si pasoj e shpejtësisë së zvogëluar të fluidit.

**107) Era ballore zvogëlon gjatësinë e nxitimit (anglisht: take-off run):**

- (a) e pa saktë,
- (b) e saktë,
- (c) me rritjen e erës ballore rritet lundrimi (the lift/drag ratio),
- (d) me rritjen e erës ballore, për shkak të rezistencës së rritur zvogëlohet lundrimi (the lift/drag ratio).

**108) Nga çka varet rezistenca e trupit i cili gjendet në rrymimin e ajrit:**

- (a) nga sipërfaqja e trupit, forma e trupit dhe shpejtësia e rrymimit të ajrit,
- (b) nga ngurtësia e trupit,
- (c) nga pesha e trupit,
- (d) nga pozita e gravitetit të trupit;

**109) Shpejtësia reale është:**

- (a) shpejtësia e fluturimit në raport me ajrin në ambient,
- (b) shpejtësia e fluturimit në raport me presionin statike,
- (c) shpejtësia e fluturimit në raport me erën që mbizotëron,
- (d) shpejtësia e fluturimit në raport me tokën.

**110) Çfarë do të ndodhë nëse gjatë fluturimit me shpejtësi minimale e rrisim këndin sulmues:**

- (a) rrisim lartësinë me shpejtësinë e njëjtë të fluturimit,
- (b) rrymimi i ajrit rrëth krahut ndahet për shkak të një këndi të madh të sulmues dhe shpie deri tek thyerja e fuqisë ngritse,
- (c) zvogëlohet fuqia ngritse,
- (d) zmadhohet fuqia e rezistencës.

**111) Shkaku i ndarjes së rrymës së ajrit nga krahët është gjithmonë:**

- (a) shpejtësia e rrymimit të ajrit shumë e madhe,
- (b) zbrazëtirat ajrore në rrymën e ajrit,
- (c) këndi sulmues shumë i madh,
- (d) shpejtësia e vogël e rrymimit.

**112) Për kënde sulmuese më të mëdha se kritike, kemi:**

- (a) thyerjen e fuqisë ngritëse,
- (b) zmadhimin e fuqisë ngritëse,
- (c) rënien e lehtë të fuqisë ngritëse,
- (d) ngritja mbetet konstante;

**113) Era e prapme gjatë ngritjes në fluturimit:**

- (a) zgjat nxitimini,
- (b) ngritja në fluturimi me erën e prapme nuk ndikon në sigurinë e fluturimit por nuk rekomandohet për pilot me përvojë të vogël,
- (c) ngritja në fluturimi me erën e prapme kërkon uljen e këndit sulmues të krahëve,
- (d) ngritja në fluturimi me erën e prapme nuk kërkon kurrrfarë masa të veçanta për pilot dhe mund ti zbatojnë të gjithë pilotët;

**114) Si e quajmë shpejtësinë në raport me ajrin:**

